

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I PËR APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-015/12

Prishtinë

29 nëntor 2012

Në çështjen juridike të:

F.T.

Pala përgjegjëse në kërkesë/Ankuesi

përfaqësuar nga

L.T.

kundër.

D.R.

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-ës, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva – Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimi të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/121/2011 (lënda është e regjistruar në AKP me numër KPA00899), i datës 7 shtator 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 29 nëntor 2012, morri këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Refeuzohet si e pabazuar ankesa e F.T..
- 2- Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/121/2011, i datës 7 shtator 2011, për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA00899.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 80 € (tetëtdhjetë euro), të cilat duhet të paguhen në Buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me datë 11 qershor 2007, D.R. ka paraqitur një kërkesë në Agjencionin Kosovar të Pronës (AKP), duke kërkuar riposedimin e ngastrës në Stanoc të Poshtëm në Vushtrri në vendin e quajtur “Ligata”, ngastra kadastrale Nr. 980, tokë ndërtimore, në sipërfaqe prej 1 ha, 55 ar dhe 15 m². Ajo ka pohuar se ajo ishte pronare e ngastrës të cilën ajo e kishte trashëguar dhe se parcela ishte humbur me datë 1 qershor 1999 si rezultat i rrethanave të vitit 1998/1999 në Kosovë.

Për të mbështetur kërkesën e saj, paraqitësja e kërkesës në mes të tjerash AKP-ës i kishte paraqitur këto dokumente:

- Ekstraktin nga Fleta Poseduese Nr. 356, lëshuar me datë 4 dhjetor 1987 nga Drejtoria Gjeodete e Komunës së Vushtrrisë, Zona Kadastrale Stanoc i Poshtëm, që tregon se ngastra e kërkuar ishte regjistruar në emër të paraqitëses së kërkesës, D.R.;
- Fleta Poseduese Nr. 356, lëshuar me datë 6 dhjetor 2006 nga Administrata e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, për Komunën e Vushtrrisë, Zona Kadastrale Stanoc i Poshtëm, vërteton gjithashtu se prona kontestuese ishte regjistruar në emër të paraqitësit të kërkesës.

Fleta Poseduese është verifikuar, AKP-ja gjithashtu ka gjet Çertifikatën e të Drejtave Pronësore në Plauajtshmeri – UL 70202028-00356 –, lëshuar me datë 11 qershor 2011 nga Zyra Kadastrale Komunale e Vushtrisë për Zonën Kadastrale Stanoc i Poshtëm, duke treguar se pronar/posedues i ngastrës Nr. 980 ishte D.R..

Me 19 prill 2010, Ekipi i Njoftimit i AKP-ës shkoi te ngastra kontestuese dhe vendosi një lajmërim për kërkesën. Njoftimi ishte kontrolluar në maj të vitit 2010 bazuar në koordinatat GPS dhe në ortofoto dhe është gjetur se ishte i saktë.

Me 12 maj 2010, X.T. paraqiti një njoftim për pjesëmarrje ne procedurën ligjore në Agjencionin Kosovar të Pronës.

Me 14 qershor 2010, F.T. kishte shkuar në AKP dhe kishte deklaruar se babai i tij, i cili kishte vdekur me 23 maj 2010 i kishte blerë ngastrat Nr. 969 dhe 980 nga një person i quajtur M. mbiemri i të cilit ishte i panjohur për të. Më pastaj babai i tij ishte i detyruar të lëshonte Kosovën dhe të shkonte në Gjermani. F.T. deklaroi se dokumentet që kanë të bëjnë me transferin ishin mbajtur në shtëpinë e tyre deri në vitin 1998. Pastaj familja ishte e detyruar të linte shtëpinë derisa lufta kishte përfunduar në vitin 1999. Kur familja ishte kthyer ata kishin gjetur shtëpinë e tyre të djegur, vetëm muret kishin mbetur.

Ai i paraqiti AKP-ës Çertifikatën e Vdekjes, të lëshuar nga Komuna e Prishtinës me 11 qershor 2010, duke treguar që X.T. nga Stanoci i Poshtëm kishte vdekur me 23 maj 2010. Ai gjithashtu i paraqiti AKP-ës Fletën Poseduese (të pavërtetuar) Nr. 189, lëshuar me datë 12 maj 2010 nga Drejtoria Kadastrale e Komunës së Vushtrisë për Zonën Kadastrale Stanoc i Poshtëm, vërteton se ngastrat no. 969 dhe 980 ishin në posedim të V.Ž.V.. Në raportin e Përpunimit të Kërkesës për KKPK-ën, Sekretariati Ekzekutiv i AKP-ës ka vërejtur se kjo Fletë Poseduese Nr. 189 përshkruan situatën e vitit 1985 dhe se hulumtimet kanë treguar se ngastra Nr. 980 në të gjitha regjistrat tani është regjistruar në emër të paraqitësit të kërkesës.

Me një shënim të datës 14 janar 2011, F.T. ka sqaruar se babai i tij i ndjerë kishte blerë 55 ari nga ngastra Nr. 980, e regjistruar në Fletën Poseduese Nr. 189. Ai ka përkujtuar se se babai i tij kishte kontratën e shkruar për shitjen dhe se ai kishte paguar 12.000 DM. Regjistrimi ishte i pamundur për shkak të ligjeve diskriminuese të kësaj kohe. Pas luftës familja kishte gjetur shtëpinë e djegur, dokumentet sipas të gjitha gjasave ishin djegur gjithashtu. Babai i tij kishte kërkuar M. por nuk e kishte gjetur atë. Më vonë dy persona të ndryshëm kishin kërkuar ngastrën, gjithashtu edhe paraqitësi

i kërkesës si V.V.Ž..

Me 7 shtator 2011, KKPK-ja me vendimin e tij KPCC/D/A/121/2011 e kishte pranuar kërkesën. KKPK-ja ka deklaruar se paraqitësi i kërkesës kishte dëshmuar cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Fleta Poseduese e paraqitur nga pala përgjegjëse në kërkesë dhe e pavërtetuar, tregonte personin e tretë si bartës të së drejtës pronësore dhe kishte bërë përshkrimin vetëm të situatës së vitit 1985, dhe jo për vitet e tjera. Dëshmi të tjera për pretendimet e tija pala përgjegjëse nuk kishte paraqitur.

Vendimi i është dorëzuar F.T. me datë 6 dhjetor 2011.

Me 22 dhjetor 2011, L.T., vëllau i F.T., ka ushtruar një ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të Komisionit për sa i takon sipërfaqes prej 55 ari të ngastrës Nr. 980. Ai ka kundërshtuar vendimin për shkak se sipas tij ai përfshihet me shkelje esenciale dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale. Ai ka përsëritur deklaratën e F.T. dhe ka bashkangjitur deklaratën e T.T. (xhaxhait) i cili ka konfirmuar se përafërsisht 55 ari të ngastrës Nr. 980 ishin blerë nga X.T. nga fqinji M. në vitin 1991 ose 1992 dhe se 12.000 DM ishin paguar. Një tjetër person, B.B., gjithashtu ka vërtetuar këto fakte në deklaratën e tij të shkruar.

D.R. është përgjegjor në ankesë, duke kërkuar që ankesa të refuzohet. Ajo ka deklaruar se ajo ishte pronare e ngastrës së kërkuar dhe se ankuesi dhe dëshmitari me emrin M.V. si shitës, nuk kanë mundur të dëshmojnë, për shkak se ky person ishte kidnapuar dhe me gjasë vvarë.

Më vonë në procedurë L.T. i ka paraqitur Gjykatës Supreme autorizimin e nënshkruar nga F.T.. F.T., ankuesi, kishte autorizuar L.T. që të përfaqësonte atë në këto procedura para AKP-ës dhe Gjykatës Supreme.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është pranueshme. Por ajo nuk është e bazuar.

Gjykata pajtohet me gjetjet e KKPK-ës se pala përgjegjëse në ankesë, D.R., ka dëshmuar të drejtën e saj në pronë.

Ankuesi nuk ka treguar ndonjë nga faktet që do të kundërshtonte pronësinë e palës përgjegjëse në ankesë.

Gjykata vëren se ankuesi ka ndryshuar daklaratën e tij gjatë procedurës. Me 14 qershor 2010 ai ka deklaruar se babai i tij kishte blerë dy parcelat Nr. 969 dhe 980, të regjistruara në Fletën Poseduese Nr. 189. Me shënimin e tij të datës 14 janar 2011, F.T. kishte ndryshuar pretendimet e tija dhe tani ai kërkon të drejtë vetëm në 55 ari të ngastrës Nr. 980.

Megjithatë, kjo deklaratë nuk dëshmon të drejtën e ankuesit rrespektivisht të babait të tij (në një pjesë) në ngastër. Transferi i pronës mund të realizohet vetëm nga pronari i pronës, personi i cili ka të drejtë në pronë. Sidoqoftë, ankuesi, deklaroi se babai i tij kishte blerë pronën jo nga V.Ž.V., por nga një person i quajtur M. [Gjykata supozon se ai ka qenë M.V. meqenëse pala përgjegjëse në ankesë ka dhënë këtë emër]. Sidoqoftë, nuk ka indikacione nëse ndonjëherë M.V. ishte pronar i ngastrës Nr. 980 ose se kishte ndonjë të drejtë në pronë. Prandaj, M.V. nuk mund të transferoj ndonjë të drejtë pronësore në babain e ankuesit.

Gjykata nuk vendos në pyetjen nëse është e mundur transferi i të drejtës së pronësisë në një pjesë të ngastrës pa bërë ndarjen zyrtare dhe pa regjistrimin e pjesëve si ngastra të veqanta.

Në përputhje me gjithë këtë, Gjykata nuk gjen vërtetim të gabuar të gjendjes faktike ose zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural në vendimin e KKPK-ës. Rrjedhimisht, ankesa sipas nenit 13.3 c) e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079 duhet të refuzohet si e pabazë dhe vendimi i KKPK-ës të konfirmohet për sa i përket lëndës e cila duhet të vendoset në këtë aktgjykim (KPA00899).

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë një përjashtim i tillë nuk parashikohet për procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë me arsye mund të vlerësohet në € 6.000: € 50.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që ka humbur rastin. Në përputhje me nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë. Neni 47 paragrafi 3 parashihet në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë atëherë bëhet zbatimimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it